


## INVESTIMI NË BONOT E THESARIT



Banka e Shqipërisë,  
Sheshi Skënderbej, Nr. 1, Tiranë, Shqipëri  
Tel.: ++355 4 222752, 222152, 223205, 235569  
(numri i brendshëm : 214)  
Faksa: ++ 355 4 223558  
adresa në internet: www.bankofalbania.org

Bonot e thesarit emetohen dhe garantohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ato shiten nëpërmjet ankandeve të organizuara nga Banka e Shqipërisë. Bonot janë emtuar për herë të parë në korrik të vitit 1994 dhe janë një nga instrumentet e borxhit të brendshëm të Qeverisë.

Bonot e thesarit emetohen në monedhë kombëtare (Lek) dhe kanë afate maturimi **3, 6 dhe 12-mujore**. Me afat maturimi kuptojmë diferencën në kohë midis datës së investimit dhe datës së kthimit të investimit.

Për bonot e thesarit me afat maturimi 3-mujor ankandet organizohen **çdo javë** ditën e martë, ndërsa me afat maturimi 6 dhe 12-mujore organizohen **çdo dy javë** po ditën e martë.

Veprimet për pjesëmarje të individëve në blerjen e bonove të thesarit kryhen gjatë çdo ditë-pune.

Shuma minimale për të marrë pjesë në blerjen e bonove të thesarit është për momentin **300.000 lekë dhe rritet me shumfisha me 10.000 lekë. Ky nivel ka tendencë rritjeje.**

Individët mund të marrin pjesë në blerjen e bonove të thesarit me paraqitjen e tyre nëpërmjet sporteleve të hapura nga Banka e Shqipërisë, si dhe nëpërmjet bankave të nivelit të dytë.

Individët duhet të paraqiten me një nga dokumentet identifikuese si letër njoftim, pasaportë, çertifikatë personale me fotografi, për të kryer veprimet që lidhen me bonot e thesarit.

Bonot e thesarit ofrojnë më shumë mundësi fitimi në krahasim me investimin në depozita bankare, duke bërë krahasimin si më poshtë për vitin 2002:

### Interesat mesatare mujore të depozitave në sistemin bankar (%)

	Interesat mesatare mujore të depozitave në sistemin bankar (%)			Yield-i mesatar mujor i ponderuar i bonove të thesarit (%)		
	3 m	6m	12 m	3m	6m	12m
Janar	6.93	7.31	7.75	7.99	9.79	10.49
Shkurt	6.94	7.33	7.72	7.99	9.79	10.48
Mars	6.91	7.39	7.75	8	9.78	10.5
Prill	6.97	7.39	7.76	8.61	10.25	19.93
Maj	7.28	7.78	8.64	9.58	11.18	11.76
Qershor	7.69	7.98	8.63	9.8	11.21	11.78
Korrik	7.96	8.21	8.74	9.79	11.27	11.79
Gusht	7.9	8.28	8.78	9.8	11.22	11.79
Shtator	7.89	8.45	8.9	10.3	11.68	12.21
Tetor	7.95	8.82	9.21	10.31	11.85	12.38

Bonot e thesarit janë të tregtueshme, pasi mund të shiten para afatit të maturimit. Bankat tregtare mund të blejnë bono thesarit deri në 7 dite para datës së maturimit.

Bonot e thesarit janë të rinvestueshme, në momentin e maturimit, para datës së ankandit bëhet rinvestimi duke paraqitur një kërkesë të re së bashku me dokumentin zotërues të saj.

Llogaritja e çmimit të interesit bëhet si më poshtë:

$$\text{Ç} = \frac{V \cdot N}{1 + Y \cdot \frac{\text{Nr.diteve}}{365 \times 100}}$$

Ku:

Ç = është çmimi i blerjes

V N = vlera nominale

Y = Yield-i

Nr.dit = numri i ditëve deri në maturim

Llogaritja e interesit = ( Vlera nominale – Çmimi i blerjes)